



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr.48

Prishtinë, më 26.12.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Arben Gashi dhe Jelena Bontiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Majlinda Doda, RTK-Radio, Besjana Bajrami, Ekonomia Online; Ardita Hajra, Aktiv, Jehona Krasniqi, KDI, Shaban Murturi dhe Edita Kusari, EUSR/EU.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu-Kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 12.11.2018;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-126 për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve;
4. Shqyrtimi i Raportit Vjetor i punës së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për vitin 2017;
5. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/22 për Kinematografinë;
8. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, pasi u hoq pika e 4 rendit të ditës sepse Znj. Florie Kika nuk ishte e pranishme për arsye të një vizite jashtë vendit dhe me mirëkuptim ka kërkuar shtyrjen e shqyrtimit të raportit, në një mbledhje tjetër. Po ashtu, kryetarja propozoi që në pikën të ndryshme, të futen Propozim-amendamentet për shqyrtim të kërkesave buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 12.11.2018;

Kryetarja konstatoi se miratohet procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 12.11.2018.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-126 për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të zgjedhurve;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim në parim Projektligjin nr. 06/L-126 për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të zgjedhurve, duke thënë se ky projektligj është proceduar nga një grup i deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nga disa subjekte politike. Pra, më shumë është lustracion dhe është i ngjashme me atë që e ka Shqipëria.

Hajdar Beqa, propozoi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, në mënyrë që të vinë më të përgatitur.

Albulena Haxhiu, kryetare, tha se ky ligj ka për qëllim të kontrollojë pastërtinë e figurës së çdo zyrtari të lartë publik të zgjedhur apo të emëruar. Në lidhje me pjesëmarrjen e tij në strukturat e politikbërjes dhe zbatuesit të sistemit komunist të ish-Jugosllavisë, si dhe dhunës nga aparati shtetëror dhe strukturat e ish-shërbimeve sekrete, për periudhën 1944-1999.

Mëtej, znj. Haxhiu tha se ky projektligj ka nevojë për shumë amendamente dhe në qoftë se kalon në parim, atëherë Komisioni për Legjislacion duhet të obligohet që ti hartojë ato, ndërsa është ftuar edhe z.Berisha për të arsyetuar procedimin e këtij projektligji.

Sami Kurteshi, tha se është i interesuar që ky ligj në parim të kalojë, por, po ashtu, tha se ka një varg vërejtjesh parimore dhe teknike. Në dokumentacionin përcjellës që e ka bërë Ministria, tha se janë mbështet gabimisht në një rezolutë të Këshillit të Evropës. Kjo rezolutë është e vitit 2006 dhe ka të bëjë me dënimin e krimeve të komunizmit, ndërsa Ligji i lustrimit, që është thelbi i këtij ligji, është i vitit 1996, e cila duhet të rregullohet.

Kurteshi pati edhe disa vërejtje tek neni 3 paragrafi 1.4, ku thuhet se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë”, që është bartje e ligjit nga Shqipëria meqë duhet të jetë “Këshilli Gjyqësor i Kosovës” apo “Këshilli Prokurorial i Kosovës”, duke pohuar se këto mund të rregullohen. Çështjet teknike, tha se nuk po i përmend sepse janë problematike, ndërsa pati vërejtje tek neni 6 paragrafi 5 dhe neni 7 paragrafi 1.2 dhe 1.4, për të cilat tha se nuk janë në logjikën e ligjit.

Kurteshi si çështje e ngriti edhe atë se si dhe sipas cilit kriter caktohen kandidatët për anëtarë të Komisionit dhe kush e bënë verifikimin e tyre? Ai pati edhe vërejtje të tjera përmbajtjesore, teknike, me ç’rast shprehu gatishmërinë për të punuar në këtë projektligj, kurse është mirë të ftohet z. Berisha, për ti sqaruar këto paqartësi.

Bilall Sherifi, tha se këtë projektligj duhet ta procedojmë në Kuvend dhe të gjitha vërejtjet, propozimet mund të diskutohen dhe rregullohen në grup të punës.

Shkumbin Demaliaj, tha se e mbështet këtë iniciativë dhe sipas tij është shumë i qëlluar si projektligj dhe propozon për tu proceduar për Kuvend.

Hajdar Beqa, tha se është ide e mirë dhe i duhet një ligj i tillë Republikës së Kosovës. Në këtë fazë, e përkrahim dhe kur të formojmë grupin e punës, do të ftohen të gjithë aktorët që të japin kontributin e tyre, qoftë ekspertë të jashtëm, por edhe nga shoqëria civile, ndërsa edhe sponsoruesi duhet të jetë pjesë e grupeve të punës.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni me 7 vota për dhe 1 abstenim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet Projektligji nr. 06/L-126 për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve.

4. Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve Kryesore për Projektligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportet e komisioneve kryesore për Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të procedohet për Kuvend.

5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim projektligjin nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund ti procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/22 për Kinematografinë;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund ti procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat;

Kryetarja, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nr. 04/L-097 për Bibliotekat dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për Bibliotekat dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm;

2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund ti procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

8. Të ndryshme.

A. Kërkesat buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit për Legjislacion;

Albulena Haxhiu, kryetarje, paraqiti për shqyrtim propozim- amendamentet për Projekt-buxhetin e vitit 2019, në lidhje me kërkesat buxhetore të institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit dhe e ftoi z. Hajdar Beqa, të marrë fjalën në cilësinë kryesuesit të grupit të punës.

Hajdar Beqa, tha se si grup i punës i kemi shqyrtuar kërkesat e institucioneve që bien në fushëveprim të Komisionit, ku ka pasur kërkesa edhe të pamundshme për ti përfshirë në buxhet, prandaj kërkoi nga anëtarët e tjerë të komisionit, që këto propozim- amendamente ti përkrahim si komision dhe ti mbrojmë edhe në seancë plenare nëse nuk përkrahen nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Kryetarja, tha se është një kërkesë e Këshillit Prokurorial, i cili ka kërkuar që të mbështetet për një koordinator të mbrojtësve të viktimave, në të cilën kërkoi që të mbështetej edhe kjo kërkesë e tyre, duke u pajtuar edhe me propozimet tjera të amendamenteve.

Hajdar Beqa, - tha se ne kemi kërkuar sqarim prej Këshillit Prokurorial dhe sigurisht mund të përkrahet edhe kjo pozitë për koordinator të Mbrojtësve të Viktimave.

Korab Sejdiu, theksoi mbështetjen për amendamentet dhe po ashtu shprehu shqetësim të thellë në lidhje me buxhetin për vitin 2019 për sektorin e drejtësisë. Edhe pse buxheti është 12.5% në rritje, por sektori i drejtësisë ka një rritje prej 6% , do të thotë, është lënë mbrapa dhe këtu nuk është vetëm faji i ekzekutivit që e ka përgatitur buxhetin, por në fakt një barrë shumë e madhe bie edhe mbi institucionet e drejtësisë. Buxheti i institucioneve të drejtësisë, nuk është i tillë që të jep rezultate reformuese, por edhe po të përkrahim këto amendamente, do të jetë vazhdimësi e të njëjtës. Prandaj, të mendohet mirë, që ti ndihmohet institucioneve të drejtësisë, për të hartuar buxhet i cili do të garantojë përmirësim gradual të performancës të këtij sektori jashtëzakonisht të rëndësishëm.

Hajdar Beqa, tha se nëse e shohim buxhetin e vitit 2018, shihet se ky sektor ka pas prioritet. Institucionet që bien në fushëveprim të komisionit tonë, 99% ka qenë të kënaqura me buxhetin. Shumica e çështjeve janë përfshirë përveç bashkëpunëtorëve profesionalë, e cila është më shumë se e domosdoshme, duke pohuar se kërkesat buxhetore janë diskutuar edhe në Ministri, para se të vijnë tek ne.

Korab Sejdiu, tha se nuk besoj që pagat kanë të bëjnë me përmirësim të sistemit të drejtësisë. Nuk bëhet fjalë vetëm për rritje të pagave, por për një problem shumë më të madh sistematik sepse sado që t'ua rrisin pagat gjyqtarëve dhe prokurorëve, prapë produktiviteti do të jetë i njëjtë. Nëse

shikohet prapë, nëse është prioritet në tri vitet e radhës, ku parashikohet rishikimi i buxheti për drejtësi, nuk ka rritje përmbajtjesore, por vetëm rritje kozmetike.

Bilall Sherifi, tha se nuk beson që çështja e sistemit të drejtësisë, duhet të shikohet se çfarë ndodhi me të në këtë mandat, por çfarë ka ndodhur në dhjetë vitet e fundit. Paga e gjyqtarëve është pesëfishuar, në krahasim me sa ka qenë më parë. Po ashtu, buxheti është dyfishuar dhe me dyfishim të buxhetit kemi katërfishim të pagave. Pra, del që është trajtuar përtej mundësive sepse në të njëjtën kohë e kemi edhe mjekun, i cili ka mbetur aty ku ka qenë para tetë viteve. Sherifi tha se sipas mendimit të tij, sistemi i drejtësisë është super i privilegjuar, në krahasim me segmentet e shërbyesve, që pa ta, shoqëria nuk mund të funksionojë.

Korab Sejdiu, tha se duhet të krijohet sistem më i shpejtë për zgjidhjen e lëndëve.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri, vendosi për miratim të propozim-amendamenteve për Projektligjin për Buxhetin 2019.

Mbledhja përfundoi në orën 13:45

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu